



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 501/prot

Gramsh 24 /2019

P/VENDIM

Nr. 12. Date 23.01/2019

Përmiratimin e një sipërfaqeje trualli prej 1000 (njëmijë) metra katrorë pjesë e pasurive numër 7/51 dhe 7/42, Zona Kadastrale numër 1842e cila është në pronësinë e Bashkisë Gramsh si truall për ndërtimin e godinës sëapartamenteve zëvendësues për familjet e prekura nga rrëshqitjet e tokës nëfshatin Kodër-Zgjupe dhe dhënie e saj nëpërdorim të shoqërisë Devoll Hydropower sh.a. për ndërtimin e godinës.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij te datës 23.01.2019, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit bazuar ne Ligjin nr. 139 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Nenet 24 pika 2 dhe 54 gërma "e"; Ligjin nr. 107/2014, datë 1.10.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKM-në nr. 408, date 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit", e ndryshuar; Ligjin Nr. 10083, datë 23.2.2009 "Për miratimin e kontratës së koncesionit..."

VENDOSI:

1. Të miratoje një sipërfaqeje trualli prej 1000 (njëmijë) metra katrorë pjesë e pasurive numër 7/51 dhe 7/42, Zona Kadastrale numër 1842 e cila është në pronësinë e Bashkisë Gramsh si truall për ndërtimin e godinës së apartamenteve zëvendësues për familjet e prekura nga rrëshqitjet e tokës në fshatin Kodër-Zgjupe sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Sipërfaqja e truallit sipas pikës 1 të këtij Vendimi i jepet në përdorim shoqërisë Devoll Hydropower në funksion të ndërtimit të godinës së apartamenteve zëvendësues për familjet e prekura nga rrëshqitjet e tokës në fshatin Kodër-Zgjupe.
3. Ky Vendim të regjistrohet pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit te tij nga Institucioni i Prefektit te Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KESHILLIT

Astrit DUZHA



KRYETARI I KESHILLIT

SHKELQIM HOXHA

Konc. Astrit DUZHA

Dakt. Shkelqim HOXHA

Dosja _____

Afati i ruajtjes 10 vjet